

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9723, DATË 3.5.2007, “PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i pikave 2 e 3, të nenit 74, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, lidhur me vlerat e gjobave për deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta dhe moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara në ligj nga bizneset. Qëllimi i këtij projektligji është adresimi i rekomandimeve të “*Financial Action Task Force*” (FATF) në raportin e progresit për Shqipërinë në tetor 2021, konkretisht të masës 5.3, sipas së cilës: “3. *Shqipëria duhet të sigurojë një kuadër ligjor të përshtatshëm për shkëlqet e detyrimeve të regjistrimit për entitetet ligjore dhe OJF-të dhe të zbatojë sanksione më proporcionale dhe bindëse, të cilat marrin parasysh treguesin e paritetit të fuqisë blerëse.*”.

Për adresimin e këtij rekomandimi, grupi i pavarur i FATF-së rekomandon se vendi ynë duhet të avancojë me ndryshimet ligjore në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, në mënyrë që sanksionet administrative të jenë më bindëse.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji aktual në fuqi parashikon aplikimin e gjobave, në rast të mospërbushjes brenda afateve ligjore të detyrimit ligjor për kryerjen e regjistrimeve përkatëse në regjistrin tregtar dhe mosdeklarimeve reale, të cilat nga ana e “*International Co-operation Review Group (ICRG)’s Financial Action Task Force*” (ICRG/FATF) janë konsideruar të ulëta dhe nuk janë në raport të drejtë me treguesin e paritetin e fuqisë blerëse të vendit, pasi në vitin 2007 PBB për frymë në PPP (*Poëer Purchase Parity*) ishte në vlerën 9151 USD, ndërsa në 2020 është 13 817.8 USD.

Për këtë arsye, për të përmbushur rekomandimin e ICRG/FATF është i nevojshëm amendimi në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e vlerave më të larta të gjobave në rast të mospërbushjes brenda afateve ligjore të detyrimit ligjor për kryerjen e regjistrimeve përkatëse në regjistrin tregtar dhe sigurimin e transparencës të të dhënave në regjistrin tregtar.

Objektivat e këtij projektligji janë:

- Forcimi i detyrimit për deklarimin e të dhënave të vërteta në regjistër nga ana e subjekteve tregtare;
- Forcimi i detyrimit për kryerjen e regjistrimeve të detyrueshme nga këto subjekte brenda afateve të parashikuara nga ligji nr.9723, datë 3.5.2007, i ndryshuar;
- Rritja e konkurrueshmërisë dhe përmirësimi i klimës së biznesit nëpërmjet deklarimeve reale dhe regjistrimit në kohë të bizneseve;
- Rritja e transparencës lidhur me deklaratimet e të dhënave nga bizneset.

Lidhur me ndryshimin e vlerës së gjobës në nenin 74 “Kundërvajtje administrative”, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, i ndryshuar, tabela nr.1 si vijon paraqet të dhënat për vendet e rajonit:

Tabela nr.1

Masa Administrative e aplikuar për shkelje në regjistrin tregtar	Greqi	Serbi	Bosnjë - Hercegovinë	Kosovë	Slovenia	Maqedoni	Mali i Zi
Vlerat	600-30000 Euro	3 muaj – 5 vjet burg	N/A	N/A	200 – 400 Euro	N/A	1000 euro

Për përlogaritjen e vlerës së gjobës është analizuar indeksi i PBB-së për frymë në PPP e disa shteteve të rajonit dhe BE-së. Referuar këtij indeksi, tabela nr.2 paraqet vlerat e PBB-së për frymë në PPP, si vijon:

Tabela nr.2 : PBB-ja për frymë në PFB Indeks (BE 27=100)

Viti	2020	Niveli i gjobës Mali i Zi	Niveli i gjobës Slloveni	Niveli i gjobës Greqi
BE (27 shtetet-nga viti 2020)	100	2174	449	938
Greqi	64			600
Slloveni	89		400	
Mal i Zi	46	1000		
Maqedonia e Veriut	38			
Shqipëri	31	674	139	291
Serbi	43			
Turqi	64			
Bosnja dhe Hercegovina	33			

Burimi: INSTAT

Sipas tabelës nr.2, vlera e gjobës e aplikuar në Mal të Zi (1000 euro), në Shqipëri do të konvertohej në një vlerë prej 674 eurosh.

Nëse një përllogaritje e tillë do të bëhej për vlerën e gjobës që aplikon Sllovenia (400 euro) do të rezultonte që në vendin tonë gjoba të konvertohej në vlerën prej 139 euro.

Nëse të njëjtën përllogaritje do ta bënim referuar vlerës minimale të gjobës që aplikon Greqia (600 euro) do të rezultonte që në vendin tonë gjoba të konvertohej në një vlerë prej 291 eurosh.

Vlera mesatare e gjobave të vendosura në rajon rezulton në një vlerë prej 370 eurosh.

Tabela nr.3 më poshtë analizon vlerën e gjobës ndaj PBB-së për frymë në PPP, duke supozuar që po analizojmë peshën e gjobës ndaj të ardhurave të familjeve në vitin 2007 dhe vitin 2020.

Tabela nr.3 PBB-ja për frymë në PPP **Error! Not a valid link.**

Viti	GDP (PPP) per capita (Int. \$) 2007	GDP (PPP) per capita (Int. \$) 2020	Vlera e Gjobes 2007	Vlera e Gjobes 2020	Share 2007	Share 2020	Propozime (USD)	Propozime (EURO)
Greqi		28,463.00		678		0.02382	329	291
Slloveni		40,124.30		452		0.01126	156	138
Mal i Zi		20,566.60		1130		0.05494	759	672
Maqedonia e Veriut		16,926.60						
Shqipëri	9,151	13,817.80	180	134	0.01967	0.00970	272	
Serbi		19,230.60						
Bosnja dhe Hercegovina		15,611.80						

Burimi : <https://data.ëorlbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.PP.CD?locations=GR>

Bazuar në analizën e mësipërme sugjerohet se vlera më e përshtatshme e gjobës që do të aplikohet në këtë projektligj të mund të jetë 60 000 lekë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrim me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 të këtij projektakti bëhet ndryshimi i pikave 2 e 3, të nenit 74, të cilat ndryshohen vetëm për sa i përket vlerës së gjobës, konkretisht në pikën 2 vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për deklarimin në regjistër të të dhënave të pavërteta si edhe në pikën 3, vlera e gjobës bëhet 60 000 lekë për moskryerjen e detyrimit për regjistrimin fillestar brenda afateve të parashikuara nga ky ligj.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit nuk shoqërohet me shpenzime financiare për buxhetin e shtetit. Qëllimi kryesor i këtij projektligji është rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve tregtare për deklarimin e të dhënave reale dhe regjistrimin fillestar brenda afateve ligjore dhe jo rritja e të ardhuravë në buxhetin e shtetit përmes gjobave. Por subjektet, që do të vazhdojnë të kryejnë shkeljet e sipërpërmendura, do të gjobiten në vlera më të larta, të cilat më pas do të arkëtohen në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE

Konceptoi: E.Toni
E.Koleka
Pranoi: E.Shtylla
Miratoi: A.Dyrmishi
Konfirmoi: A.Gjokuta
B.Kadia
Datë: 13.12.2021